

Universiteti i Prizrenit University of Prizren	
Universiteti i Prizrenit UNIVERSITETI I PRIZRENIT	
23.12.2022	
Nr. 308	Nr. 03-399

**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
KËSHILLI SHKENCOR**

**PLANI VJETOR  
2023**



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
Rruga e Shkronjave Nr. 1 | 20000, Prizren | Republika e Kosovës



# PLANI VJETOR 2023

## Këshilli Shkencor | Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

### Fushëveprimtaria e Këshillit Shkencor

Funksionimi i Këshillit Shkencor të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, mbështetet në detyrat dhe obligimet që burojnë nga Ligji për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statuti i Universitetit, Rregullorja për Kërkime shkencore dhe Plani strategjik i Universitetit.

### Përbërja e Këshillit Shkencor të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

**Prof. Ass. Dr. Ziriye Hasani, Prorektore-kryetare**

Prof. Asoc. Dr. Ercan Canhasi, anëtar

Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Izer Maksuti, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Izer Maksuti, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Ajka Aljilji, anëtare

Z. Besim Loshaj, përfaqësues i BKI, anëtar

Znj. Anesa Emini, përfaqësuese e Parlamentit Studentor, anëtare

Udhëheqësi/Koordinatori i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Transfer të dijes



## **OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

- 1. Objektivat strategjike të avancimit të punës kërkimore-shkencore**
  - 1.1. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve kërkimore-shkencore**
  - 1.2. Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe masave nxitëse për promovimin e punës kërkimore-shkencore**
  - 1.3. Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori ndërkombëtare**
  - 1.4. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në punën kërkimore-shkencore**
  - 1.5. Rritja e numrit të punimeve shkencore të botuara në revista me renome ndërkombëtare (të indeksuara në platformat Web of Science dhe Scopus)**
  - 1.6. Organizimi i konferencave shkencore në bashkëpunim me partnerët strategjik ndërkombëtar**
  - 1.7. Organizimi i konferencës shkencore të UUHP**
  - 1.8. Organizimi i Shkollës Verore Ndërkombëtare**
  - 1.9. Rishikimi i strategjisë për të rritur bashkëpunimin në hulumtime shkencore të stafit akademik të fushave të ngjashme hulumtuese**
  - 1.10. Organizimi i punëtorive dhe seminareve në nivel Universiteti**
  - 1.11. Ngritja e kapaciteteve të Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes përmes ekspertëve të jashtëm**
  - 1.12. Hartimi i temave për hulumtim të bëhet në koordinim me BKI në nivel të fakulteteve dhe me bizneset në përgjithësi**
  - 1.13. Hartimi i planit për thithjen e fondeve për projekte kërkimore-shkencore**
  - 1.14. Rishikimi i strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore 2020-2024**



---

## PLANI I AKTIVITETEVE DHE MASAVE

### 2. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve kërkimore-shkencore

#### 2.1. Ngritja e kapaciteteve të stafit menaxhues të QKITD

- 2.1.1. Hartimi i kërkesave të njëjësive akademike për infrastrukturën e nevojshme për realizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore
- 2.1.2. Kërkesa për sigurimin e ekspertit të jashtëm këshillues për ngritjen e kapacitetit të stafit menaxhues të QKITD
- 2.1.3. Identifikimi i nevojave për investime në infrastrukturën e QKITD (krijimi i hapësirave, pajisja me inventar, pajisjet laboratorike, kabinetet e informatikës, pajisjet teknologjike, certifikimi etj)
- 2.1.4. Ofrimi i propozimeve dhe rekomandimeve për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm shkencor.

#### 2.2. Zbatimi i politikave dhe masave nxitëse për punën kërkimore-shkencore

- 2.2.1. Verifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së të arriturave kërkimore-shkencore të stafit akademik me kriteret e përcaktuara në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, ri-emërimin dhe avancimin e personelit akademik.
- 2.2.2. Hartimi i raporteve të verifikimit dhe kontrollit të vërtetësisë së punimeve shkencore lidhur me shpërblimet monetare të stafit të rregullt akademik, të parapara sipas Nenit 10.1. të Rregullores për Kërkime shkencore.

#### 2.3. Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori ndërkombëtare

- 2.3.1. Nxjerrja e rekomandimeve lidhur me cilësinë e kongreseve/konferencave ndërkombëtare në të cilat parashihet përkrahja financiare dhe mbulimi i plotë i shpenzimeve për stafin akademik, të parapara sipas Nenit 10.2. të Rregullores për Kërkime shkencore.

#### 2.4. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në punën kërkimore-shkencore

- 2.4.1. Nxjerrja e rekomandimeve lidhur me mbështetjen financiare të studentëve për pjesëmarrje në kongrese, konferenca ose punëtori studentore me punime shkencore.
- 2.4.2. Përkrahja aktive e anëtarëve të Këshillit Shkencor në organizimin dhe mbarëvajtjen e Konferencës shkencore të studentëve.



---

**2.5. Rritja e numrit të punimeve shkencore të botuara në revista me renome ndërkombëtare (të indeksuara në platformat Web of Science dhe Scopus)**

- 2.5.1. Organizimi i fushatës informative lidhur me shënjestrimin e revistave shkencore për publikime në platformat e me renome ndërkombëtare.
- 2.5.2. Informimi i personelit akademik lidhur me revista të dyshimta.
- 2.5.3. Nxjerrja e rekomandimeve dhe përkrahja aktive në publikimin e Revistës shkencore të Universitetit.

**2.6. Organizimi/bashkëorganizimi i konferencave shkencore**

- 2.6.1. Bashkëorganizimi i konferencës me Universitetin e Pamukale
- 2.6.2. Bashkëorganizimi i konferencës në kuadër të projektit Research CULT në maj 2023
- 2.6.3. Organizimi i konferencës shkencore për studentë

**2.7. Organizimi i konferencës shkencore të UUHP**

- 2.7.1. Formimi i Këshillit organizativ për konferencën shkencore
- 2.7.2. Definimi i temave të konferencës

**2.8. Kontributi aktiv në mbarëvajtjen e aktiviteteve shkencore të Shkollës Verore**

- 2.8.1. Hartimi i propozimeve lidhur me aktivitetet shkencore në kuadër të organizimit të Shkollës Verore
- 2.8.2. Organizimi i punëtorive tematike, seminareve profesionale, ligjëratave të hapura me personalitete të rëndësishme publike, dhe promovimi i librave dhe punimeve artistike.

**2.9. Rishikimi i strategjisë për të rritur bashkëpunimin në hulumtime shkencore të stafit akademik të fushave të ngjashme hulumtuese**

- 2.9.1. Nxitja e stafit akademik për të bashkëpunuar me kolegë në hulumtime kërkimore-shkencore
- 2.9.2. Hartimi i planit kërkimor-shkencor nga çdo fakultet ku specifikohet tema kërkimore dhe grupi i stafit akademik që do të punojnë në atë temë
- 2.9.3. Hartimi i temave për hulumtim të bëhet në koordinim me BKI në nivel të fakulteteve dhe me bizneset në përgjithësi



---

2.9.4. Nxitja e grupeve kërkimore-shkencore për hulumtime të përbashkëta duke i dhënë prioritet për mbështetje financiare sipas Rregullores në fuqi

## **2.10. Organizimi i punëtorive dhe seminareve në nivel Universiteti**

2.10.1. Hartimi i propozimeve nga njësitë akademike për vitin akademik aktual të punëtorive dhe seminareve që do t'i ofrojnë në fakultetet e tyre

2.10.2. Kontributi i stafit akademik në aktivitetet me komunitetin si seminare, këshilla, etj. Të përfshihet në vlerësimin e performancës së stafit akademik të definuar me Rregullore.

## **2.11. Ngritja e kapaciteteve të Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes përmes ekspertëve të jashtëm**

2.11.1. Kërkesa drejtuar ITP-së dhe GIZ-it gjerman për sigurimin e lokacionit në ITP për themelimin e Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes

2.11.2. Hartimi i Rregullores për Themelimin dhe funksionimin e Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes

2.11.3. Planifikimi i aktiviteteve të Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes

2.11.4. Hartimi i propozimeve nga njësitë akademike për vitin akademik aktual të trajnimeve dhe këshillave për komunitetin që do t'i ofrojnë në kuadër të QKITD

2.11.5. Themelimi i qendrës dhe strukturave organizative duke u bazuar në rregulloret përkatëse

## **2.12. Hartimi i temave për hulumtim të bëhet në koordinim me BKI në nivel të fakulteteve dhe me bizneset në përgjithësi**

2.12.1. Mbajtja e mbledhjeve me BKI nga çdo Fakultet

2.12.2. Hartimi i listës së temave hulumtuese ku përfshihen industria

2.12.3. Raportimi për publikimet e përbashkëta mes UUHP dhe industrisë



---

### **2.13. Hartimi i planit për thithjen e fondeve për projekte kërkimore-shkencore**

- 2.13.1. Definimi i prioriteteve dhe temave për projekte nga çdo fakultet
- 2.13.2. Identifikimi i thirjeve në ERASMUS+, HORIZONT, IPA, etj
- 2.13.3. Përkrahja për aplikime për projekte

### **2.14. Rishikimi i strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore 2020-2024**

- 2.14.1. Raportimi sa janë përmbushur objektivat e Planit strategjik kërkimor-shkencor 2020-24
- 2.14.2. Formimi i grupit punues për rishikimin e Planit strategjik kërkimor-shkencor 2020-24 nga Senati i UUHP



---

## KALENDARI I AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT SHKENCOR

### JANAR 2023

- Evidentimi dhe publikimi në WEB faqe të UUHP i punimeve shkencore të stafit të rregullt akademik të UUHP për vitin 2022
- Plotësim ndryshimi i Rregullores për Kërkime shkencore
- Kërkesë Këshillit Drejtues për sigurimin e buxhetit për QKITD
- Rishikimi i strategjisë kërkimore-shkencore 2020-2024
- Të arriturat nga Konferenca e parë shkencore BRIDGE-2022
- Përgatitjet për organizimin e konferencës studentore

### SHKURT 2023

- Takim informues për stafin rreth revistave shkencore të dyshimta
- Përgatitja për publikimin e punimeve shkencore të prezantuara në konferencën BRIDGE-2022
- Përgatitjet për organizimin e konferencës studentore
- Hartimi i udhëzuesit për funksionimin e Këshillit shkencor

### MARS 2023

- Bashkëorganizimi i Konferencave shkencore
- Të arriturat nga Konferenca e bashkëorganizuar
- Takim rreth Identifikimit të nevojave për investime në infrastrukturën e Instituteve kërkimore-shkencore
- Përkrahja e aktiviteteve të Konferencës shkencore të studentëve
- Organizimi i konferencës shkencore për student

### PRILL 2023

- Analizimi i të arriturave nga konferenca e studentëve





---

## MAJ 2023

- Të arriturat dhe ngeçjet në punën e Këshillit Shkencor të UUHP
- Bashkëorganizimi i konferencave
- Themelimi i grupit punues për organizimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare
- Takim pune lidhur me organizimin e Shkollës Verore
- Shpallja e thirrjes publike për aplikimin për shpërblime financiare për publikimin e punimeve shkencore
- Verifikimi dhe kontrolli i vërtetësisë së punimeve shkencore për shpërblime monetare.

## QERSHOR 2023

- Verifikimi dhe kontrolli i vërtetësisë së punimeve shkencore për shpërblime monetare.
- Organizimi i fushatës informative për stafin akademik dhe studentë lidhur me shënjestrimin e revistave shkencore për publikime shkencore
- Takim pune lidhur me organizimin e Shkollës Verore

## KORRIK 2023

- Përkrahja e stafit akademik dhe studentëve për aplikime në projekte hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare
- Takim pune lidhur me organizimin e Shkollës Verore
- Përgatitjet për organizimin e Konferencës së parë shkencore nga UUHP

## GUSHT 2023

- Mbajtja e Shkollës verore ndërkombëtare



---

### **SHTATOR 2023**

- Diskutimi lidhur me organizimi i Shkollës Verore Ndërkombëtare dhe rekomandimi për përmirësime për organizimin e ardhshëm.
- Përgatitje për organizimin e konferencës së dytë të UUHP 2023

### **TETOR 2023**

- Nxjerrja e rekomandimeve nga Konferencat e bashkëorganizuara
- Mbajtja e takimit me tërë stafin akademik rreth mundësisë së rritjes së publikimeve në Platformat Scopus dhe Web of Science

### **NENTOR 2023**

- Shpallja e thirrjes publike për aplikimin për shpërblime financiare për publikimin e punimeve shkencore
- Verifikimi dhe kontrolli i vërtetësisë së punimeve shkencore për shpërblime monetare.
- Kërkes Dekanëve të njësive akademike që të hartojnë Planin e punës për vitin 2024

### **DHJETOR 2023**

- Verifikimi dhe kontrolli i vërtetësisë së punimeve shkencore për shpërblime monetare.
- Përgatitja e raportit final për mbështetje financiare sipas masave nxitëse të parapara në Rregulloren për Kërkime shkencore dhe dorëzimi në Këshillin Drejtues të UUHP
- Nxjerrja e rekomandimeve nga bashkëorganizimi i Konferencës
- Përgatitja e planit të punës e Këshillit Shkencor të UUHP për vitin 2024
- Përgatitja e raportit të punës së Këshillit Shkencor për vitin 2023p
- Hartimi i raportit nga çdo njësi akademike të aktiviteteve jashtë kurikulare gjatë vitit 2023
- Mbajtja e konferencës së dytë shkencore të organizuar nga UUHP
- Kërkesë drejtuar stafit akademik për dorëzimin e raportit për realizimin e planit të punës për vitin 2023.